



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:113116

Datë: 21.12.2020

Numri i dokumentit: 01358383

P.nr.105/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit: I. (N.) Q., nga fsh.K, me qka ka kryer vepër penale "**Lëndim i leht trupor**" nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/ll.nr.1320/2020, të dt. 08.09.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit: Suada Hamza nga Prokuroria Themelore në Pejë, dhe të pandehurit I. Q., pas mbajtjes së seancës fillestar të dt. 25.11.2020, në të njëjtën ditë publikisht shpalli, kurse me datën: 21.12.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I. Q., lindur me dt..... në fsh.K., ku dhe tani banon, i biri i N. dhe e nëna N., e vajzërisë Th., ka të kryer shkollën fillore me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, identifikohet me nr.Personal:, i nacionalitetit shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se:

Me datën 30.07.2020, rreth orës 08:00 minuta, në fsh.K., pikërisht në shtëpinë e tij, ushtron dhunë fizike ndaj bashkëshortës së tij, të dëmtuarës N. Q., në atë mënyrë që ditën kritike pas një zënke verbale që kishin pasur në mes veti, për shkak se një ditë më parë e dëmtuara kishte kontaktuar në telefon me një shoqe për të përfutuar dy krerë lopë, nga ndihmat që po shpërndaheshin, i pandehuri e kishte penguar dhe refuzonte ndihmat, dhe të nesërmën kishte kërkuar nga e njëjta që ti hedh ujë për ta pastruar gotën, pasi që e dëmtuara refuzon ti qes uj, menjëherë i pandehuri kishte filluar ta godas të dëmtuarën me grushta në kokë, dhe në krah e të cilës i kishte shkaktuar lëndime trupore.

-me qka ka kryer vepër penale "**Lëndim i leht trupor**" nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të të KPRK-se,

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 50, 51, 52 dhe 73 si dhe nenit 185, par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, :

DËNIM ME KUSHT

I. Me dënim gjobë shuma në vlerë prej 400 (katërqind) €, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale.

LIROHET: I pandehuri nga shpenzimet e procedurale konform dispozitave ligjore.

UDHËZOHET: Pala e dëmtuar N. Q., nga fsh.K....., qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngrit aktakuzë, P/Il.nr.1320/2020 të dt: 08.09.2020, ndaj të akzuarit për veprën penale „lëndim i leht trupor" nga neni 185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt: 25.11.2020 gjatë të cilës u dëgjuan Prokurorja e Shtetit: Suada Hamza nga Prokuroria Themelore në Pejë, e cila bëri leximin e aktakuzës ku i akuzuari i lartëcekur, u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, sipas aktakuzës, dhe ka shtuar se kërkoj falje dhe premtoj se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, dhe është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin.

Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin,e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti propozoj gjykatës qe pranimi i fajësisë të mërret si rrethanë lehtësuese në matjën e dënimit, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPRK-së, neni 248.

Gjykata pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe pas konstatimit se pranimi i fajësisë nga i pandehuri përkon plotësisht me kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 248 të KPRK-së, e aprovon pranimin e fajësisë nga i pandehuri si të bazuar, me bindje të plotë se i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë sipas deklaramit të vullnetit të lirë të tij pa kurrfarë presioni, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbeshetetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar nuk leshohet në procedurë të provave për t'i nxjerrë dhe administruar ato, për faktin së nuk ka qenë e obliguar sipas ligjit, mirëpo për të mos e mbështetur vendimin e saj vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 262 të KPRK-së, provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndes, e të cilat prokurori i shtetit ka propozuar në aktakuzë që të nxirren dhe administrohen në shqyrtim gjyqësor si prova, i vlerësoj secilën një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, duke vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë dividualizimit të dënimit, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së tij gjykata vlerësoj si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë së të pandehurit, pendimin e tij për veprën penale të kryer, si dhe sjelljen e ti korrekte në gjykatë, dhe premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjajshme penale, faktin se i pandehuri më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduesë gjeti kryerjen e veprës penale.

Gjykatës i pandehuri ia ka dorëzuar dëshminë se është shfrytëzues i skemës sociale me nr. të QPS në Klinë 7178 me afat prej dt. 01.10.2020 gjerë me dt. 01.10.2021.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përcaktuara në nenin 73 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi, i shqiptuar ndaj të pandehurit është adekuat dhe në harmoni me peshën e veprës penale, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale, në atë mënyrë që me të njëjtin të arrihet qëllimi i dënimit, pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale të ngjashme apo të tjera në të ardhmën, me bindje të plotë se dënimi i shqiptuar do të ndikoj si preventivë speciale dhe gjenerale për të pandehurin, si dhe personat e tjerë për tu përmbajtur në kryerjen e veprave penale të tilla.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur, duke marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, aprovoj aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, për dhëniën e dënimit meritor, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave ligjore të nenit 453 par.4 të KPPRK-së, i pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, dhe konform dispozitave ligjore të nenit 25 par.2, 26 par.2, 297, 365 dhe 470 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA KLINË

P.nr. 105/2020 të datës 21.12.2020

**Gj y q t a r j a
Sabrije Rraci**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.